



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 26.09.2013
Nr. 0234-1157

PËR: Avni Kastrati, Kryetar i Komunës së Mitrovicës
Rrustem Musa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË Mitrovicës, Nr. 02/06-21482/4, të pranuar me datën 25.09.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit NR. 04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare, Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 02/06-21482/4, të miratuar me datë 29.08.2013 nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik.

- Vendim Nr. 02/06-21482/4, për caktimin e lokacionit me destinim për ndërtimin e objektit të Qendrës së Shëndetit Mendor në Mitrovicë.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 26.08.2013
Br. 0234 - 1157

Za : Avni Kastrati, Gradonačelnik Opštine Mitrovica.
Rustem Musa, Predsedavajući Skupštine Opštine Mitrovica.

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI UREBE OPŠTINE MITROVICA
Nr. 02/06-2148/4, Prilmljeno dana,25.09.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravunë Br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premjera i Ministarstva, posle razmatranja Uredbe Br. 0206'21482-4, usvojene dana 29.08.2013, od Skupštine Opštine Novo Mitrovica **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom Br.03/L- 040 za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt niže neveden,ima puni pravni efekat.

- Odluka br. 02/06-21482/4,za odredjivanje lokalcije za izgradnju objekta Cantra Mentalnog Zdravlja u Mitrovici .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanikpremijera & Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivu MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica

KUVENDI I KOMUNËS
Nr. 02/06 – 21482/4 dt. 29.08.2013
Mitrovicë

02/06-21482/4
29.08.2013
Mitrovicë - Mitrovica


Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 alineja d, nenin 14 dhe nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenin 6 dhe nenin 10 paragrafi 1 nënparagrafi I të Ligjit Nr. 04/L-144 dt. 22.11.2012 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; nenin 10 paragrafi g të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 29.08.2013 pasi shqyrtoi Propozim-vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 15-01-3604 dt. 06.08.2013 për caktimin e lokacionit me destinim për ndërtimin e objektit të Qendrës së Shëndetit Mendor në Mitrovicë, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02/06 – 20059/4 dt. 15.08.2013); sjell këtë:

VENDIM

1. Me këtë vendim CAKTOHET lokacioni me destinim për ndërtimin e objektit të Qendrës së Shëndetit Mendor në Mitrovicë.
2. Lokacioni për ndërtimin e objektit sipas pikës 1 të këtij vendimi, përfshinë sipërfaqen prej 1400 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 105864 m² të Parcelës kadastrale P-71208072-01870-0 - me kulturë parcelë, e cila gjendet në vendin e quajtur "Spitali Ushtarak", e evidentuar si pronë komunale sipas Certifikatës së pronës Nr. UL-71208072-003300 – ZK Mitrovicë.
3. Lokacioni sipas pikës 2 të këtij vendimi i IPET në shfrytëzim Ministrisë së Shëndetësisë, në afat prej 99 (nëntëdhjetenëntë) vitesh, pa procedurë konkurrimi dhe në pajtim me nenin 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-144 dt. 22.11.2012 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.
4. Ky vendim paraqet bazë për caktimin e kushteve urbano-teknike për rregullimin e hapësirës së lokacionit nga pika 2 e këtij vendimi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb faqen e Komunës.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit


Dr. Rrustem MUSA

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL
1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës
Të gjitha drejtorive